


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 663 Akti
Datë Regjistrimi 12.05.2021

Nr. 5934/3 Vendimi
Datë 16.06.2021

VENDIM

Mbi Depozitimin e Akteve ne Regjistrin e Organizatave Jofitimpruese

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë e përbërë nga:

GJYQTAR : ARBEN MULLAJ

me cilësinë e gjyqtarit të vetëm, sot më date 16.06.2021, mori në shqyrtim kërkesën që i përket :

- KËRKUES:** “Komiteti Olimpik Shqiptar”, regjistruar si person juridik me nr. 5934, datë 22.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm Stavro Bello.
- OBJEKTI:** Depozitimin në Regjistrin e Organizatave jofitimprurëse e vendimeve të Asamblesë së 24-të të Përgjithshme zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, datë 17.04.2021.
- BAZA LIGJORE:** Ligji nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, i ndryshuar; Ligji nr.8789 datë 07.05.2001 “Për Regjistrimin e Organizatave Jofitimprurëse”, Ligji 79/2017 “Pwr Sportin”, i ndryshuar.

Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi, aktet shkresore bashkangjitur kërkesës, Depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jo Fitimpruese të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të vendimeve të Asamblesë së 24-të të Përgjithshme zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, datë 17.04.2021.

VEREN

Në bazë të Akteve të akteve të depozitura, në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, Komiteti Olimpik Shqiptar është regjistruar si person juridik me vendimin nr. 5934, datë 22.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me Kërkesën objekt shqyrtimi, kërkuesi kërkon Depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurese të vendimeve të Asamblesë së 24-të të Përgjithshme zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, datë 17.04.2021 si vijon:

-Zgjedhja e z. Fidel Ylli President të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

-Zgjedhja e z. Erlind Pellumbi, zv. President të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

-Zgjedhja e z. Genc Boga, mbajtës i thesarit të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.

-Zgjedhja e anetarëve të Komitetit Komitetiet Ekzekutiv të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar: Gjergj Ruli, Luiza Gega, Florend Kalivopulli, Enkelejda Çausi, Tatjana Marash, Labo Çapo, Endrit Hoxha

Gjykata vlereson se vendimarrja sa sipër është në përputhje me percaktimet ligjore, e dispozitat statutore.

Në këto rrethana, Gjykata vlereson së dokumentacioni i paraqitur nga Shoqata për Depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vendimeve të Asamblesë së 24-të të Përgjithshme zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, datë 17.04.2021, është në përputhje me ligjin e si i tillë duhet pranuar.

PER KETO ARSYE

Gjykata në bazë të Ligjit Nr.8788 datë 07.05.2001 “ Për organizatat jofitimprurëse”, Ligjit Nr.8789 datë 07.05.2001 “ Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”, Ligji 79/2017 “Pwr Sportin”, i ndryshuar.

V E N D O S I

Pranimin e kërkesës.

Depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të, vendimeve të Asamblesë së 24-të të Përgjithshme zgjedhore të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, datë 17.04.2021.

Urdhërimin e sekretarit të regjistrit të organizatave jofitimprurëse të regjistrojë vendimin sa sipër dhe të pasqyrojë ndryshimet në skedën perkatëse.

Tiranë më datë 16.06.2021.

